




RAPORT TEKNIK

MIRATOHET
SEKRETARI I KKTKM
JOLI MITROJORGJI


Grupi i punës:

Ark. Vilma Hashorva
Ark. Ronela Çuku
Ing. Bledian Rakipi



Contents

1. Vendndhodhja	2
2. Të dhënat Historike	2
3. Analiza Arkitektonike	3
4. Gjendja e monumentit ndër vite:	4
Gjendja e monumentit në vitin 1987	5
Gjendja e monumentit në vitin 2007	5
Gjendja e monumentit në vitin 2010	8
5. Evidencimet e problematikave / ndërhyrjet restauruese dhe konservuese.....	10
Patologjitë - Naosi	10
Patologjitë - Narteksi dhe amienti përreth	11
Patologjitë - ambienti përreth kishës.....	12
6. Ndërhyrje – “plani i dyshemesë”	12
Ndërhyrjet restauruese të parashikuara - Naosi.....	12
Ndërhyrjet restauruese të parashikuara - Narteks	12
Ndërhyrjet e parashikuara - ambienti përreth kishës.....	13
7. Objektivat që priten të arrihen me këtë projekt.....	15
8. Specifikime teknike.....	16



1. Vendndhodhja


Kisha e Shën Sergjit dhe Bakut është e pozicionuar Brenda mureve të Kalasë së Himarës, në kuotën më të lartë të saj. Ajo përfaqëson selinë e dikurshme të peshkopatës së Himarës.



Pamje ajrore e Kishës së Shën Sergjit dhe Bakut_Himarë

2. Të dhënat Historike

Kisha e Shën Sergjit dhe Bakut përfaqëson selinë e dikurshme të peshkopatës së Himarës, e cila del për herë të parë në dokumentacionin historik në fund të shek. X në *Noticie* e Jan Cimiskës, dhe në vitin 1019, kur i aneksohet kryepeshkopatës së Ohrit. Ajo është ndërtuar në vendin më të lartë të fshatit, në anën veriore dhe pranë mureve të kalasë. Kisha përbëhet nga naosi, mjedisi i altarit, të ndarë nga njëri tjetri nëpërmjet një ikonostasi prej muri dhe narteksi në anën perëndimore. Muret e kishës ruajnë disa faza ndërtimore, ndërsa ndërtimit fillestar i përkasin pjesët e poshtme të murit të naosit. Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme, faza e parë e monumentit është datuar në fundin e shek. X dhe fillim i shek. XI. Në brendësi të kishës ruhen piktura murale, kryesisht në ambientin e bemës, që i përkasin periudhës pasbizantine.




3. Analiza Arkitektonike

Kisha e Shën Sergjit dhe Bakut është e pozicionuar në pikën më të lartë të kalasë. Muret e kishës ruajnë gjurmë të rindërtimeve të shumta. Kisha përbëhet prej narteksit, naosit dhe mjedisit të altarit, të ndare me një ikonostas të vonë prej muri. Kisha iu përket dy fazave kryesore të ndërtimit. Ndërtimi fillestar i takon naosi me pjeset e poshtme të mureve, sepse pjeset e sipërme janë rindërtuar disa herë. Narteksti përbën një ndërtim më të vonë dhe për këtë, na bindin si teknika e ndërtimit, edhe fugat e kontaktit. Këtij rindërtimi i takon dhe muri ndarës naos – narteks. Muret e vjetra janë ndërtuar me gurë gëlqerore të madhësive mesatare dhe të vegjël. Të skuadruara janë veçm qoshet. E vecanta e murit të vjetër është prania në të e copërave të tjegullave, të vendosura njëra mbi tjetrën ndërmjet gurëve ose dhe në rradhë të shkurtra ndërmjet rradhëve të gurëve. Një imitim i dallueshem i kësaj teknike është meremetimi i pjesës së sipërme të murit verior dhe atij jugor të kishës.

E tilla është në pjesën veriore qoshja lindore e meremetuar në vitin 1783, si dhe pjesa e sipërme nën çati, në një lartësi 80 cm. në këtë mur ndodhet një portë e murosur. Edhe muri jugor ka të rindërtuar pjesën e sipërme. Më vonë është hapur edhe porta në anën jugore, e ndërtuar në një mur të ri. Në anën lindore fuga është vertikale që tregon se duhet të jetë shtatull portë.

Në murin lindor sot të suvatuar, pjesët në dukje janë të ndërtimit fillestar. Në këtë anë del absida gjysme rrethore, mjaft e madhe, që përbën një vecanti të kishës. Pë datimin e monumentit do të prireshim të shihnim në ndërtimin e parë një kishë të fundit të shek 10 dhe fillimit të shek 11, kur Himara del për herë të parë si qendër peshkopale. Deri në një farë mase për këtë u fut edhe teknika e ndërtimit, e cila, duhet pranuar mbetet në përdorim edhe në shekujt e mëvonshëm.

Planimetria e Kishës së Shën Serxhit dhe Bakut_Himarë, fazat e ndërtimit






Pamje nga Kisha e Shën Sergjit dhe Bakut-Himarë (Fasada veriore)


4. Gjendja e monumentit ndër vite:

Gjendja e monumentit në vitet '80 të marra nga arkivi i IKTK-së

- Narteksit nuk ka çati.
- Vërehen çarja e thellë në muraturen perëndimore të narteksit.



Gjendja e monumentit në vitin 1987



Gjendja e monumentit në vitin 2007

- Narteksit vazhdon të mos jetë i mbuluar me çati ;
- Porta në fasadën perëndimore është e tamponuar me mur guri;
- Vërehen grumbullime inertesh në brendësi të ambientit të narteksit dhe prezencë vegjetacioni të lartë dhe të ulet.
- Çarje sipërfaqësore në fasadën perëndimore të Naosit.





Pamje nga Kisha e Shën Sergjit dhe Bakut-Himarë (Fasada perëndimore)





Pamje nga brenda ambientit të Narteksit (fasada perendimore e Naosit)



Gjendja e monumentit në vitin 2010

- Hajati vazhdon të jete i pa mbuluar më çati
- Vërehen që çarjet në murin perëndimor janë po të njëjtat si në vitin 2007;
- Gjatë punimeve mirëmbajtëse/restauruese është bërë heqja e tamponimit të përtesë perëndimore të narteksit dhe vendosja e puntelimit të drurit si dhe vendosja e dy trentëve metalik që bëjnë lidhjen e dy fasadave atë jugore dhe asaj veriore të narteksit;
- Është bërë edhe vendosja e ndriçuesve në fasadë;
- Vërehet rritja e vegetacionit në brendësi të narteksit (vegjetacion i ulët dhe i lartë).



Pamje e fasades perendimore





Pamje nga brenda ambientit te Narteksit (vërehen tirantet metalike)

Gjendja e monumentit në vitin 2018

- Hajati vazhdon të jete i pa mbuluar më çati
- Vërehen që çarjet në murin perëndimor janë po të njëjtat si në vitin 2010;
- Gjatë punimeve mirëmbajtëse/restauruese është bërë heqja e puntelimit të drurit.
- Vërehet rritja e vegjetacionit në brendësi të narteksit (vegjetacion i ulët dhe i lartë).



Pamje e fasadës perëndimore (Narteksi)





Pamje e fasadës jugore(Narteksi)

5. Evidencimet e problematikave / ndërhyrjet restauruese dhe konservuese

Nga vëzhgimi ispecialistëve restaurator në vend, u konstatua sa mëposhtëm:

Patologjitë - Naosi


- *Prezence Lagështie*; Ambienti i naosit nuk paraqet probleme konstruktive, por ka problematik të theksuar sa i përket prezencës së lagështisë e cila vjen nga kreu i muraturës. Mendohet së duke marrë parasysh faktin që nga ana e jashtme e naosit muratura është e çrregullt, nuk është plotësisht vertikale, por vende vende ka gjerësi më të madhe të tij për nga jashtë (kjo si rezultat i ndërhyrjeve të herë pas herë në muraturë përgjatë viteve). Streha e çatisë është karakteristike për zonën, me një dalje rreth 10 cm për nga jashtë murit.

Duke patur parasysh që kisha ndodhet në pikën më të lartë të kalasë ku edhe erërat janë të forta në periudhën e dimrit, dalja e strehës prej 10 cm. jashtë murit nuk arrin që të sigurojë mbrojtjen apo largimin e ujërave nga muratura.

- Degradim i suvasë si rezultat i prezencës së lagështisë;
- Degradim i dyer dritareve;
- Degradimi i dyshemesë, pllaka guri që lëvizin;



- Dëmtim i shkalles prej guri ne pjesën e altarit, mungese e materialit guror.
- Evidentimi i penetrimit të rrezeve të dritës nga çatia si rezultat i rrëshkitjes së tjegullave të çatisë;
- Evidentimi i degradimit të lidhësit dhe mungesë fugature;
- Çarje sipërfaqësore në murin perëndimor të naosit;
- Evidentim i çarjeve ne muraturën e altarit.



Evidentim/ Ndërhyrje "Plani i dyshemese"

Patologjitë - Narteksi dhe amienti përreth

- Prezencë bimësie e lartë dhe e ulët në brendësi të narteksit;
- Mungesë e pllakave të gurit në dysheme;
- Çarje të thella dhe lëvizje nga vertikaltetë i muraturës së narteksit dhe më konkretisht fasada perëndimore dhe ajo jugorë. Çarjet në murin perëndimor mendohet se kanë ardhur si rezultat i lëkundjeve sizmike para viteve 80. Duke marrë parasysh edhe faktin që ky ambient prej shume kohësh nuk ka patur një brez lidhës dhe një strukturë çatie, ka bërë që në pikën më të dobët, muri perëndimor mbi qemerin e portës hyrëse dhe dritares mbi të, të pësojë çarje dhe lëvizje nga vertikaltetë. Ndërsa çarja në murin jugor midis portës perëndimore dhe asaj jugore ka ardhur jo vetëm si rezultat i mungesës



së brezit lidhës në kreun e muraturës por edhe si rezultat i rrënjëve të një peme qiparisi në ambienti e brendshëm të naosit.

- *Evidentimi i degradimit të lidhësit dhe mungesë fugature;*
- *Mungesë e brezit lidhës;*
- *Mungesë kapuçimi i murature;*
- *Ndërhyrje e mëvonshme me 2-3 rreshta gurësh duke dalë mbi nivelin e muraturës së naosit;*
- *Ndërhyrje e mëvonshme, mur B/A hyrja e sterës;*
- *Prezencë mbeturinash dhe dherash/gurë në ambientin e strës;*

Patologjitë - ambienti përreth kishës

- *Prezencë vegjetacioni në krahun jugore dhe lindor të kishës;*
- *Dëmtim i murit rrethues krahu jugor i kishës;*

6. Ndërhyrje – “plani i dyshemesë”

Ndërhyrjet restauruese të parashikuara - Naosi

- *Restaurim i çatisë së naosit;*
- *Restaurim i suvasë;*
- *F.V dyer dritare;*
- *Restaurim i dyshemesë së naosit;*
- *Restaurimi i shkallës prej guri në pjesën e altarit;*
- *Konsolidim i muraturës prej guri dhe ri fugatim i tij atje ku është i nevojshëm;*
- *Konsolidim i çarjeve në muratur me teknikë e injektimit;*
- *Konsolidim i çarjeve në muratur e altarit me teknikë e injektimit;*
- *Ndriçim i ambientit të naosit.*

Ndërhyrjet restauruese të parashikuara - Narteks


- *Pastrim mekanik nga bimësia e larte dhe e ulet në ambientin e narteksit, spërkatje me herbicide për tharjen e rrënjëve të këqija;*
- *Restaurimi dhe plotësimi i shtresës së dyshemesë ekzistuese me pllaka guri të ngjashme me ato ekzistueset.*
- *Pastrim i sterës, prishje e konstruksionit B/A dhe ndërtim mur guri në gryken e saj. Vendosje kapaku sipër grykës;*
- *Prishje e 2-3 rreshtave të gurit (shtuar me vonë) mbi kreun e muraturës;*
- *Restaurim i muraturës në fasadën perëndimore dhe atë jugore të narteksit më teknikën shqep-qep;*
- *Konsolidim i kreut të miraturës;*
- *Konsolidim i murit të narteksit më teknikën e injektimit;*
- *Restaurim/fugatim murature ku është i nevojshëm;*
- *F-V brez lidhës druri në kreun e muraturës së narteksit;*



- *Ndërtim çati ke konstruksion druri mbuluar me tjegulla vëndi;*
- *Rstaurim i strehes prej guri nw portwn veriore;*
- *F.V Dyer dritare;*
- *Restaurim i kangjellave metalik ekzistues, pastrim me letër smeril, lyerje me antiruxhe dhe boje vaji.*
- *Ndriçim i ambientit të narteksit;*
- *Heqjen e tirandave metalik ekzistues ne fasade pasi te jete bere i gjithë përforcimi i muraturës së dëmtuar.*


Ndërhyrjet e parashikuara - ambienti përreth kishës

- *Pastrim mekanik nga bimësia e larte dhe e ulet në ambientin përreth, spërkatje me herbicide për tharjen e rrënjëve të këqija;*
- *Resaturim i murit rrethues krahu jugor i kishës;*
- *F.V stola druri;*
- *F.V Kosh mbeturinash;*
- *F.V tabelë informativë;*
- *Ndriçim i jashtëm i kishës.*




7. Objektivat që priten të arrihen me këtë projekt

Ndërhyrjet restauruese do të kenë për qëllim ruajtjen e vlerave origjinale të monumentit dhe paraqitjen e tyre në mënyrë sa më dinjitoze karshi vizitorëve vendas dhe të huaj. Konsolidimi i strukturës do të bëjë të mundur arritjen e stabilitetit statik të monumentit dhe trajtimi i monumentit si pjesë e rëndësishme e itinerareve turistike do të rrisë interesin për këtë monument.



8. Specifikime teknike



1. Specifikime të përgjithshme

1.1 Njësitë matëse:

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Ton (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

1.2 Qëllimi i punës:

Kontraktori duhet të bëjë kujdes në zbatimin e punimeve sipas projektit të miratuar në KKR në përputhje dhe me kushtet e kontratës si dhe të plotësojë çdo difekt gjatë punimeve. Kontraktuesi do të sigurojë që drejtuesi teknik i punimeve restauruese të jetë prezent gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve, gjithashtu personeli i kualifikuar për këto tipologji punimesh. Kontraktuesi do të sigurojë materialet, pajisjet dhe të gjitha sendet e tjera, qoftë të një natyre të përkohshme ose të përhershme, të nevojshme për zbatimin dhe përfundimin e punëve, dhe për korrigjimin e ndonjë defekti, për aq sa është e specifikuar në këtë dokument, ose mund të nxirret në mënyrë të arsyeshme gjatë zbatimit të kontratës nga Drejtuesi i Projektit më tej i quajtur Mbikqyrësi i Punimeve.

1.3 Grafiku i punimeve:

Kontraktuesi duhet t'i japë Mbikqyrësit të Punimeve një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në restaurim deri në mbarim të punës.

Informacioni që duhet të sigurohet mbikqyrësit të punimeve duhet të përfshijë:

- Vizatime grafike që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të ansamblit dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim;
- detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme;
- plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim e restaurim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim,
- detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga Mbikqyrësi i Punimeve të restaurimit, dhe *çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga mbikqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të punimeve.*

1.4 Punime të gabuara:

Çdo punë, që nuk është në përputhje me projektin e aprovuar nga KKR, dhe këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit. Në rastet kur kontraktori i punimeve restauruese gjykon të adaptojë punime gjatë procesit të restaurimit në funksion të këtij procesi, *çdo ndryshim bëhet me aprovim të Mbikqyrësit të Punimeve dhe këto adaptime nuk duhet të prekin thelbin e projektit.*



1.5 Punime të rrezikshme:

Magazinimi i bombolave të gazit me presion në ambientet e brendshme të monumentit është e ndaluar. Gjatë punimeve të rrezikshme me gazrat e ndezshme duhet mbajtur fikësezjarrit sipas DIN EN 3 duhet të jetë në dispozicion pranë me vendin ku punohet.

1.6 Tabelat njoftuese, etj:

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç: Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Mbikqyrësi i punimeve dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 100 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

1.7 Sigurimi Teknik:

Kontraktori do të zbatojë të gjitha punimet sipas standarteve Europiane dhe Shqiptare të sigurimit teknik në punë. Ai duhet të sigurojë një plan për sigurimin teknik dhe staf të kualifikuar për inspektimin e sigurimit teknik, kryerjen e instruktimit teknik për çdo punonjës dhe për çdo zë pune specifik. Gjatë punimeve të prishjes punëtorët duhet të veshin rroba të duhura të sigurisë duke përfshirë syze në mbrojtjen e syrit, maska pluhuri, këpucë të sigurisë, doreza të punës dhe kasketa të forta. Mbajtjen e procesverbaleve për çdo lloj aksidenti në punë dhe mbarëvajtjen e sigurimit teknik të cilin duhet tja prezantojë Mbikqyrësit çdo muaj.

2. Dorëzimet te Mbikqyrësi i Punimeve:

2.1 Autorizimet me shkrim:

“Rregullat me shkrim” do t’i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Mbikqyrësi i Punimeve të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë zbatimin e kësaj kontrate. Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuar, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje), aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Mbikqyrësit të punimeve do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

2.2 Dorëzimet tek Mbikqyrësi i punimeve:

Kontraktori duhet t’i dorëzojë Mbikqyrësit: *për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Mbikqyrësi.* Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkojnë nga Mbikqyrësi. Mbikqyrësi i Punimeve do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të



kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Mbikqyrësin e Punimeve dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Mbikqyrësit për të bërë këto pranime.

2.3 Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç është zbatuar)

Kontraktori duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “siç janë zbatuar faktikisht” në terren. Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Kontraktori do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e “Vizatimeve siç është zbatuar”. Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t’i dorëzohen Mbikqyrësit të punimeve çdo muaj për aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje letër.

Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lëna gjatë gjurmëve dhe vendosjen ekzakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Kontraktori gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gjurmimit.

Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve, “siç është zbatuar” do t’i dorëzohen Mbikqyrësit për aprovim.

2.4 Mostrat:

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Mbikqyrësi për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Mbikqyrësit.

2.5 Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuar do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikqyrësit të Punimeve i cili duhet të jetë i argumentuar dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë apo origjinalitetit të veprës. Nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuar; ose nëse materialet e specifikuar nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Kontraktorit, që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

2.6 Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave:

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Mbikqyrësit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Mbikqyrësi, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.



2.7 Dokumentat dhe vizatimet:

Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasi të dhe detajet të treguara në Vizatimet, Grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Kontraktorin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

2.8 Fotografitë e sheshit të ndërtimit;

Kontraktori duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve.

3. Objekte ekzistuese:

3.1 Shërbimet e brendshme:

Prioritet është që para fillimit të prishjeve shërbimet komunale në zonën e prishjeve do të nxirren jashtë funksioni dhe të sigurohen që rifutja në punë e paqëllimshme të ndalohet.

Gjatë cmontimit të elementëve të suvatuara të tilla si mure, xokol, suvaja duhet prerë pastër në kufijtë e seksionit të prishur.

3.2 Betonet dhe pllakat:


Prerja me sharrë e betonit duke hapur dhe pllakat në një thellësi prej 5 centimetra nën gjendejn ekzistuese pranë. Prerjet të jenë të drejta dhe në kufijtë e shtresës që do hiqet. Matrapikët do të përdoren vetëm në pjesën e prerë dhe nuk do të përdoren në vend të sharrës.

4. Gërmimet:

Të mbushen të gjithë pjesët e gërmuara, kanale, gropa dhe pjesë të rrezikshme të hapura në tokë. Të tregohet kujdes gjatë gërmimeve pjesore, ato duhet të kryhen me krahë.

4.1 Hedhja e materialeve ekzistuese dhe pajisjeve:

Duke përjashtuar rastet ku tregohet në specifikime, në raste të tjera të gjitha materialet dhe pajisjet largohen dhe nuk ripërdoren. Do të bëhen pronë e Kontraktuesit dhe do të largohet nga kantieri. Titullimi për të gjitha materialet që rezultojnë nga cmontimi, dhe pajisjeve që do të hiqen, i vishet Kontraktuesi me miratimin e Mbikëqyrësit. Me autorizim nga Mbikëqyrësi mund të fillojnë punimet për prishjen. Klienti nuk do të jetë përgjegjës për gjendjen, humbjen ose dëmtimit të pronës pas njoftimit të fillimit të prishjeve. Materialet dhe pajisjet nuk do të shiten nga blerësit e mundshëm apo të shiten në kantier.



4.2 Kontrolli i pluhurave:

Të merren masat e duhura për të kontrolluar përhapjen e pluhurit dhe për të shmangur krijimin e një zonë të papërshtatshme përreth. Të jetë në përputhje me të gjitha rregulloret e pluhurit të vendosura nga kantieri dhe agjensitë lokale të ndotjes së ajrit. Gjatë prishjes së ndërtesave të cilat janë ende në përdorim duhet të vendosen perde pluhurit për të mbrojtur ato zona ende nën funksion të qarkullimit të pluhurit me ajrin. Kur elementet që prishen përmbajnë materiale fibra atëherë duhet patur kujdes për të shmangur përhapjen e fibrave dhe në këtë mënyrë ndotjen. Njomja e materialit të tillë dhe përdorimi i maskave të pluhurit do të konsiderohet një masë minimale të mbrojtjes. Shpimit në materiale fibroze është i ndaluar.

5. Mbrojtja:

5.1 Puna ekzistuese:

Para fillimit të punëve Kontraktuesi së bashku me Mbikqyrësin duhet të inspektojnë dhe të identifikojnë të gjitha njësitë ekzistuese të cilat do të mbahen ose të ripërdoren. Një punë e tillë ekzistuese e cila është: (a) të mbeten në vend, (b), për ripërdorim, ose (c) të mbetet pronë e Klientit, do të mbrohet duke përdorur mbulesa të përkohshme, përforcuese dhe parandaluese. Objektet të cilat do mbeten dhe të cilat janë të dëmtuara gjatë kryerjes së punës do të riparohen në gjendjen e tyre origjinale ose të zëvendësohen me të reja me shpenzimet e Kontraktuesit. Nuk duhet të mbingarkohen elementet strukturore. Duhet siguruar mbështetje të reja dhe përf forcime për ndërtimet dobësuara ekzistuese nga punimet e prishjeve. *Në asnjë moment për çfarëdolloj arsye nuk duhet të rrezikohet struktura.* Nëse vihet re humbja e stabilitetit të strukturës (devijime të mëdha) atëherë Kontraktuesi do të marrë masa të menjëhershme për të siguruar punimet dhe të evakujë dhe të izolujë zonën dhe të informojë mbikëqyrësin.

5.2 Zbritja e Materialeve:

Kur materialet ose mbeturinat zbriten nga lartësitë, kujdes duhet të merret për të parandaluar levizjet e materialeve, rënien në mënyrë të tillë që ajo krijon një rrezik për sigurinë e personelit ose të pronës publike të çdo lloji.

5.3 Shërbimet ekzistuese:

Telat ekzistuese elektrike dhe përcjellës që mbeten do të shkëputen me kujdes nga instalimet/kapëset e tyre (pa shkëputje), të ri pozicionohen jashtë vendeve ku aktualisht punohet dhe të mbrohen nga dëmtimi. Para prishjes së punimeve kontraktuesi do të kontrollojë për vendndodhjen e shërbimeve të padukshme.

5.4 Dëmtimet gjatë Dimrit:

E gjithë ndërtesa duhet të jetë e mbrojtur nga dëmet e dimrit të tilla si ngrirja se tubave të ujit etj gjatë punimeve të prishjeve. Nuk duhet të punohet në temperatura më të ulëta se 5°C.



5.5 Punimet e Çatave:

Gjatë punimeve të çatave Kontraktuesi do të sigurojë ndërtesën nga kushtet e motit në çdo kohë. Mbulimi I perkohsem eshte parashikuar sipas specifikimeve dhe grafikisht ne project per te siguruar mbrojtjen ndaj motit duke qene se objekti ne muret e brendshme te naosit eshte I veshur I gjithi me piktura murale dhe tavane decorative. Në përgjithësi heqja e mbulimit duhet të bëhet në koordinim me fazat e punimeve të çatisë në mënyrë që kërkesa e mbulimit të perkohshëm të jetë në minimum.

5.6 Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetës publike rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtesave dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Sipërmarrësi duhet të vendosë dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë pengesa të përshtatëshme, shenja me dritë të kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

5.7 Mbajtja pastër e ambjentit përreth monumentit:

Rruga hyrëse në objekt dhe ambjenti përreth tij që përdoret aktualisht si varrezë, do të mbahen pastër cdo ditë. Kontraktuesi do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e objekteve përreth dhe ambjentit duke siguruar hyrje / daljen e materialeve nga kantieri.

Mbrojtja e pemëve:

Të gjitha pemët të cilat nuk janë të aprovuara për prerjen duhet të mbrohen nga dëmtimi gjatë tërë periudhës së kontratës. Pemët me diametër më të madh se 10 cm dhe të larta deri 1m mbi tokë (shkurret, barërat etj) do të priten, pa lejen paraprake të autoriteteve dhe të mbikëqyrësit.

Mbrojtja e ambjentit

Sipërmarrësi duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundëshme për të siguruar që ambjenti lokal i ansambilit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

6. Shërbimet e jashtme:

6.1 Shërbimet elektrike dhe komunale

Duhet të mbrohen të gjitha shërbimet elektrike dhe komunale. Kontraktuesi do të zbulojë të gjitha shërbimet nëntokësore në kantier para fillimit të punimeve të gërmimit. Lejet e gërmimit do të merren nga furnizuesit e shërbimeve dhe një kopje do të dorëzohet tek Mbikëqyrësi. Kur heqja e shërbimeve ekzistuese dhe kalldrëmit është specifikuar apo të nënkuptuara, do të sigurohen barrikada të miratuara, mbulimin e perkohshëm ne zonat e



ekspozuara dhe lidhje të përkohëshme për sistemet elektrike dhe të shërbimeve komunale. Distanca e nevojshme e punës të sigurt nga lart për linjat e tensionit të lartë do të caktohet dhe të miratohet me kompaninë e shpërndarjes elektrike. Një kopje e kësaj leje do të lëshohet nga Mbikqyrësi. Kontraktuesi do të ketë kohë të mjaftueshme para fillimit të punimeve, të informojë autoritetet përkatëse në mënyrë që mund të ndërmerren hapat e nevojshëm për të bërë të mundur spostimin e kabllave.

6.2 Skelera

Të gjitha skelat duhet të projektohen dhe të montohen në përputhje me standardet e kërkuara. Vetëm punëtorët me përvojë dhe kompetent do të montojnë skelerinë në lartësi. Kontraktuesi do të sigurojë që çdo modifikim të nevojshëm të skelave gjatë rrjedhës së punëve, do të pranohen nga montuesit e skelave në mënyrë që skela do të mbetet i përshtatshëm për qëllimin për të cilin janë të dedikuara. Nënshkrimi i miratimit të skelës do të bëhen i dukshëm në çdo pikë të hyrjes në nivel të tokës tek skela. Punimet në skelë të paautorizuara është rreptësisht e ndaluar. Duhet patur kujdes që ngarkesa e cdo grumbulli mbeturinash në skelë nuk e duhet ta kalojë ngarkesën e lejuar sipas projektimit. Ngarkesat maksimale të lejueshme të skelave do të jenë qartë të dukshme në të gjitha pikat e hyrjes në nivelin e tokës. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hedhjen aksidentalisht të mbeturinave nga platforma. Skela metalike e tipit mbështetës, në përputhje me standardet dhe rregullat lokale, duke përfshirë furnizimin e mbështetëses, mirëmbajtjen, montim, ankorimit, çmontimin etj 15cm nga dyshemeja do të vendosen në të gjitha nivelet. Copë mbrojtëse ndaj motit ose të paktën rrjetë mbrojtëse duhet të vendoset në pjesën e jashtme të skelës.

7. Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Kontraktori, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatëshme për t'i mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyrësi i Punimeve në çdo kohë.

8. Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.

9. PUNIME PRISHJEJE-ÇMONTIMI DHE PASTRIMI

9.1 Të përgjithshme

Punimet e prishjes dhe çmontimit në restaurim janë një proces i rëndësishëm, në të duhet të marrin pjesë punëtorë të specializuar të cilët duhet të mbikëqyren në çdo rast nga drejtuesi teknik i punimeve. Nëpërmjet prishjes evidentohen gjurmë të reja të cilat sjellin dëshmi të



reja lidhur me monumentin të cilat duhet të dokumentohen. *Materialet e nxjerra nga çmontimi pas seleksionimit nëse nuk janë të dëmtuar ripërdoren.*

REFERENCAT: Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi të referencave të zgjeruara. Botimet që janë të referuara në tekst janë të përcaktuara vetëm për gjërat bazë. m³

9.2 Ligjet dhe Normat e aplikuara shqiptare:

- Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me parimet e “Kartës Shqiptare të Restaurimit”, VKM. Nr.426, 13 Korrik 2007.

- Ligji Nr.9048, datë 04/07/2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, (I ndryshuar)

9.3 DORËZIMET : Dorëzimet në vijim:

9.2.1 Deklarimet: Dorëzimi i procedurave të propozuara të prishjeve dhe heqjes së materialeve tek Mbikqyrësi për miratim, para se puna të fillojë. Procedura do të sigurojë heqjen e kujdesshme dhe sistemimin e materialeve në koordinim me veprat e tjera në proces, dhe një orar për mospengimin e shërbimeve komunale, të gjitha lejeve të nevojshme nga kompanitë e furnizimit e të shërbimeve. Një përshkrim të detajuar të metodave dhe pajisjeve që do të përdoren për çdo punë dhe të vazhdimin të punëve që kryhen.

9.2.2 Kushtet e mbikqyrjes: Në rastet kur prona fqinje mund të dëmtohet nga punimet atëherë Kontraktuesi duhet të kryejë me shpenzimet e tij një studim të detajuar të gjendjes së pronës fqinje përfshirë këtu edhe dokumentacionin fotografik një kopje e të cilit duhet të paraqitet dhe të miratuar nga Mbikqyrësi para fillimit të punimeve.

9.2.3 KËRKESAT: Puna përfshin çmontimin dhe largimin e të gjitha materialeve të diktuar ose të specifikuar. Punimet e prishjeve nuk do të fillojnë deri sa autorizimi të merret nga Mbikqyrësi. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja, përveç nëse tregohet apo të specifikohet ndryshe, do të largohen nga kufijtë e sheshit të ndërtimit. Mbeturinat do të hiqen nga kantieri çdo ditë, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Mbikqyrësi; akumulimi i materialit të tillë është i ndaluar. Materialet të cilat nuk mund të hiqen brenda ditës do të ruhen në mënyrë të përshtatshme në zonat e përcaktuara. Nëse Kontraktuesi identifikon kalbësira në dru gjatë punimeve të çmontimit ai do të marrë masat e duhura për sigurinë e shëndetit. Njoftohet menjëherë Mbikqyrësi dhe i propozohen masa të përshtatshme për miratim. Kontraktuesi duhet të paraqesë prova për asgjësimin e duhur të materialeve me kërkesë të Mbikqyrësit.

9.4 Pastrimi i kantierit

9.4.1 Pastrimi i kantierit:

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirqjet e mbeturinave të tjera.



9.4.2 Mbrojtja e objekteve, rrethimeve dhe strukturave:

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë objektet dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.

Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese të çdo lloji.

Duhet bërë kujdes nga kontakti me kabllot elektrik.

9.4.3 Mbrojtja e vendit të pastruar:

Kontraktori duhet të ngrëjë rrjetë të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

9.5 Punime prishjeje


9.5.1 Skeleritë:

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim i objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skeleri çeliku të tipit këmbalec, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parrakë vertikale, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parrakë vertikale, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.



9.5.2 Mbikqyrja

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

9.4.3 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objekteve.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë statike të objektit.

Kur prishja e elementeve të ndërtesës nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të stukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e çmontimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, *pa ndërhyrë në elementët bazë struktural*. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

10. NDËRHYRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE

10.1 Të përgjithshme

Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me Projektin e miratuar në KKR si dhe parimet e “Kartës Shqiptare të Restaurimit”

10.2 Shpjegim i terminologjisë


“Konservim” janë të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në vepër siç janë krijimi i kushteve mjedisore (lagështi relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, mbrojtja nga pluhurat, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), si edhe ndërhyrjet kimike direkt në objekt apo vepër, me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.

“Ndërhyrje” është tërësia e masave të ndërmarra dhe operacioneve të kryera në vepër, me qëllim ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe nxjerrjen në pah të vlerave të saj.

“Restaurimi” është vlerësimi i thelbit origjinal të monumentit nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjen në pah të vlerave të tyre.

Këshillat mbi Parimet dhe Metodatat të cilat ofrojnë udhëzimet e propozuara të ndërhyrjeve restauruese duhet të lexohen së bashku me këtë dokument.

10.3 Ndërhyrjet në “monumentet e kulturës”



Në disa raste nevojat për konservim duhet ti paraprijnë atyre të vendosjes në siguri, në vazhdim nuk është e nevojshme të rregullohen nivelet e sigurisë të një ndërtese historike me ato ndërtesave të reja por është e mjaftueshme që nivelet e sigurisë të përmirësohen krahasuar me ato para ndërhyrjes.

Teknikat e ndërhyrjeve që do përdoren në monumentet e kulturës duhet të respektojnë karakteristikat historike, artistike, arkitektonike dhe shpërndarjen e tyre. Kjo do të thotë që përmirësimi duhet të realizohet pa prodhuar modifikime substanciale në sjelljen e strukturës dhe ndërtesës duke përdorur për sa është e mundur teknika ndërhyrje dhe metodologji operative tradicionale, konservim të materies, kushteve fizike dhe morfologjike. Teknika dhe materiale me karakter reversibël edhe pjesor që përdoren në mënyrë diskrete, jo evazive dhe në koherencë me llogjikën konstruktive të strukturës ekzistuese.

11. PUNIME PRISHJE DHE PASTRIMI TË ELEMENTËVE TË OBJEKTIT

11.1 Skelë me tubo fasade dhe tavani ~ 8m

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një sektor kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Gjate kryerjes së punimeve meqenese kemi nje territor qe perdoret vazhdimisht nga kalimtarët, duhet të merren masa që të bëhet veshja e pjesës së sipërme të skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.


Ky çmim përfshin ndërtimin skeles përgjatë gjithë fasadës jashtme të objektit për të realizuar të gjithë punimet në muraturë, konstruksionin për mbulimin provizor si dhe konstruksionin e catise. Në mënyrë që skela të krijoi siguri duhet të jetë metalike, tubolare e kolauduar brenda vitit të fundit.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

11.2 Prishje mur guri me pastrim

Ky çmim përfshin prishjen e muraturës e plotësuar me gure gelqeror, ne pjesen e kreut te siperm te muratures se narteksit. Do te behet prishja me kujdes ne mënyrë manuale e gureve te shtuar deri ne lartesine e kuotes se murit ekzistues sipas shenjave te fugave ne murature. Njëkohësisht bëhet pastrimi, përgatitja e sipërfaqes qe do te konsolidohet ne menyre qe te ringrihet catia qe mungon ne kete pjese te ambientit.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.



11.3 Prishje solete beton arme e nxjerre konsol në fasade

Ky çmim përfshin prishjen e ullukut prej betoni ne fasaden jugore te kishes. Prishja do të bëhet në mënyrë manuale me matrapik ose me dalte në mënyrë të kujdesshme, duke ruajtur elementët e tjerë të ndërtesës që të mos dëmtohen. Më pas do të përgatitet sipërfaqja që do të plotësohet me material guri njëlloj si pjesa tjetër e fasadës. Materialet e prishjes do të grumbullohen dhe do të depozitohen në vendin e caktuar nga Bashkia.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

11.4 Prerje e elementeve metalik të inkastruar në muraturën prej guri

Prerja e elementeve metalik do të bëhet me gurë zmeril (troko). Prerja do të realizohet me kujdes në mënyrë manuale, pak më në brendësi të nivelit të fugave të fasadës në mënyrë që këto trarë të mbulohen sipër me fugatim uniform me të gjithë fasadën dhe që të mos të jetë vizibel me sy të lirë. Materialet e prishjes do të grumbullohen dhe do të depozitohen në vendin e caktuar nga Bashkia.

Ky çmim është për njësi Lekë/ cope.

11.5 Heqje dyer dritare prej druri

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve të çmontimit të elementeve të degraduar prej druri të dritareve dhe dyerve si pasojë e mos mirëmbajtjes së tyre në vite. Elementët e rinj që do të zëvendësohen do të jenë të ngjajshëm me ato origjinalë.

Realizohet para punimeve të tjera si ato të restaurimit të murit apo suvasë. Elementët e rinj të dyerve dhe dritareve që do të zëvendësohen do të përdoret dru pishe i stazhionuar.

Ky çmim është për njësi Lekë/m².

11.7 Pastrim nga bimësia e ulët+injektim i solucionit për tharjen e bimëve të këqija

Ky zë përfshin gjithë pastrimin nga bimësia e ulët në muraturë si dhe ambjentin përreth banesës, në mënyrë mekanike si dhe spërkatja e sipërfaqes me herbicide për përtharjen e tyre.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

11.8 Prerje dhe tharje të rrënjëve masive (raundap 200cc)

Prerja të rrënjëve të pemës të cilat ka mbire në murin e ndërtesës, si dhe spërkatjen me herbicide për përtharjen e rrënjëve të pemës.

Ky çmim është për njësi Lekë/ copë.

11.9 Pastrim nga shtresa e suvasë së dëmtuar në muret e brendshme te ndërtesës

Në momentin e sistemimit të territorit të jashtëm, pasi zgjidhim dhe problemin e lagështirës nga jashtë do të lëmë përtharjen e lagështirës në muraturë dhe aty ku konstatojmë duke dëgjuar tingullin e saj me anë të trokitjes, që suvaja jo e pikturuar është tepër e shkëputur do të bëjmë prishjen me kujdes të saj me mjete jo të forta me qëllim mos dëmtimin e suvasë të padëmtuar. Në çmim do të përfshihet dhe kruajtja dhe pastrimi me furçë të sipërfaqes ku



ka rënë suvaja. Gjithashtu do te behet dhe pastrimi i fugave i cili do të fillojë me pastrimin mekanik të fugave nga llaçi degraduar apo i punuar pa kujdes dhe me material të papërshtatshëm. Pas pastrimit mekanik, duhet të bëhet larja e tyre me ujë të bollshëm. Rifugatimi do të kryhet me llaç gëlqere të majmë.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

12.0 Çmontim çatie (tjegulla vendi)

Përpara fillimit të punimeve të restaurimit të çatisë, kryhen punimet e çmontimit të elementëve të mbulesës. Per zbulimin e saj duhet te punohet me skeleri, në mënyrë të tillë që elementët që hiqen si nga çatia dhe tjegullat të mos dëmtohen. Punimet duhet të kryhen me kujdes, për të zbuluar ndonjë element apo gjurmë të fazave më të hershme. Per çfarëdollojë gjetje të re të tillë, e cila nuk është e identifikuar në vizatime dhe përshkrime të njoftohen specialistët e IMK dhe projektuesit.

Pra në çmimin e këtij zëri punimi, përfshihen tërësia e punimeve që duhet për zbulimin, uljen në tokë, stivosjen dhe pastrimin e materialit të dalë nga prishja e kësaj çatie ekzistuese , si dhe pastrimin e murit te sipërm të ndërtesës nga të gjitha mbeturinat e çatisë, e cila përfshinë në detaje:


Heqjen me kujdes të tjegullave dhe seleksionimi i tjegullave të pa dëmtuara, të cilat do të depozitohen dhe zbriten me kujdes në tokë nëpërmjet ulluqeve të krijuar, dhe rradhiten , për t'u ripërdorur, duke i sistemuar sipas grupimeve në terren. Tjegullat në gjendje të mirë dhe dimension të përshtatshëm, që do të ripërdoren, duhet të lahen dhe pastrohen me furçë të ashpër në mënyrë që nga sipërfaqja e tyre të largohen të gjitha llojet e myshqeve dhe papastërtitë e tjera, duke krijuar një sipërfaqe perfekte të tyre.

Heqja e lëndës drusore, kryhet në objekt, ku nga gjendja e verifikuar ajo është e papërshtatshme për tu ripërdorur, në këto kushte ajo do të sistemohet dhe stivohet në një vend të përcaktuar nga Mbikqyrësi i punimeve, dhe do të jetë në ruajtje nga sipërmarësi i punimeve, duke e inventarizuar dhe dorëzuar bashkë me objektin. Lënda drusore do jetë e pastruar nga gozhdët dhe hekurat lidhës dhe duhet stivohet në mënyrë të tillë, që të ajroset dhe të mos mbajë lagështirë.

Heqja dhe çmontimi i shtresës së petavrave të drurit (dërrasave të shtruara në çati) e cila duket shumë e dëmtuar. Këto pastrohen nga gozhdët dhe mbeturinat dhe stivohen me dërrasat e tjera sipas përshkrimit të mësipërm.

Mbasi bëhen këto punime paraprake, në prezencë të kontraktorit, dhe mbikëqyrësit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë që do të përdoret brenda kushteve teknike dhe për pjesën e dëmtuar që do të hidhet.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m² çati në plan .



12.1 Pastrim ambjenti nënçati

Ky ze përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin nga papastërtitë dhe pluhurat që ndodhen në ambientin nënçati. Para pastrimit verifikohet gjendja jashtë funksionit e elektricitetit në instalimet elektrike që mund të ndodhen aty dhe në bazë të verifikimit për gjendjen teknike të tyre merret vendim për çmontimin dhe largimin e mundshëm të tyre. Pastrimi nga papastërtitë dhe pluhurat bëhet në mënyrë mekanike dhe me makineri thithëse. Ky çmim është për njësi Lekë / m².

12.2 Gërmim dhe transport dherash

Ky çmim parashikon gërmimin e dherave të grumbulluar në vite në brendësi të ambientit të kishës dhe në ambientin përreth tij, për të eliminuar kështu gjithë lagështirën në brendësi të muraturës si pasojë e mosmirëmbajtjes së objektit. Uljen e kuotës së tokës dhe nivelimin e dherave në pjesën e oborrit të brendshëm të narteksit deri në zbulimin e kuotës së dyshemese ekzistuese të tij. Dherat e tepërta grumbullohen për t'u hedhur, në vendet e përcaktuara nga komuna.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

12.3 Gërmim me sondazh arkeologjik

Ky ze punimi parashikon gërmimin e dherave dhe inerteve të grumbulluara në ambientin e narteksit të grumbulluara si pasojë e mungesës së catise. Gërmimet do të behen nën monitorimin e arkeologut dhe jo më thellë se 30cm. Për çdo gjetje që do të behet gjatë procesit të punimeve do të pezullohen punimet dhe do të njoftohet mbikqyresi i punimeve.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

12.4 Gërmim e mbushje dheu për themele

Gërmimet do të behen sipas aksit 1-1 dhe 3-3 (në faqen perendimore dhe në faqen e ikonostasit prej guri), deri në gjetjen e tabanit të themelit, tabani do të kontrollohet nga mbikqyrsi i punimeve. Do të mbahet një procesverbal mbi thellësinë e arritur dhe nëse kuota e tabanit është më pak se një meter atëherë nuk ka nevojë për forcim themeli.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

12.5 Transport material ndërtimi, dheu me auto deri në 10 km

Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për transportin e mbeturinave dhe ngarkimin shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia deri në 10 km larg nga kantieri.



Ky çmim është për njësi Lekë/ m³

13. SPECIFIKIMET TEKNIKE PER NDËRHJRJET RESTAURUESE

13.1 Mur guri themel e xokol

Ky ze punimi perfshin teresine e punimeve qe do te kryehen per konsolidimin e themelit te gjithë muratures se narteksit te kishes e cila ka pesuar cedim, si dhe perforcimin e ikonostasis prej guri. Gjithashtu do te parashikohet dhe perforcimi i shpatit ne pjesen jug-perendimore nese do te gjykohet e arsyeshme nga mbikqyresi gjate procesit te punimeve.

13.2 Restaurim mur guri llac gelqere

Restaurim muri guri me llaç gëlqere 1:3, konsiston ne kontrollin e mureve te demtuar , plotesimin e gureve qe mungojne, ose zevendesimin e gureve te demtuar te ngajshem me ta. Do të aplikohet zëvendësimi i materialit të gurit të dëmtuar me material të ri me të njëjtin litotip duke siguruar integritetin e muraturës. Perforcimi i mureve te kishes te cilet pasi te jete bere pajantimi do te nderhyet pjese pjese cdo nje meter.

Ne kete cmim perfshihet blerja e transporti I te gjitha matrialeve te nevojshme , dhe cdo gje qe lidhet me kete proces.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

13.3 Pastrim i murit ne krye, nen cati

Ky përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin nga papastërtitë dhe pluhurat që ndodhen në ambjentin nënçati. Para pastrimit verifikohet gjendja jashtë funksionit e elektricitetit në instalimet elektrike që mund të ndodhen aty dhe në bazë të verifikimit për gjendjen teknike të tyre merret vendim për çmontimin dhe largimin e mundshëm të tyre. Pastrimi nga papastërtitë dhe pluhurat bëhet në mënyrë mekanike dhe me makineri thithëse. Ky çmim është për njësi Lekë / m².

13.4 Restaurim muri guri me llaç gëlqere 1:3 me teknikën shqep-qep

Problemi kryesor i muraturës është prezenca e lagështise dhe degradimi i materialit lidhës i cili ka sjellë dhe formimin e disa çarjeve. Këto pjesë do të restaurohen me teknikën shqep-qep. Prishja do të bëhet pjesë-pjesë dhe mbas prishjes së një pjese do të puntelohet menjëherë. Me tej pjese pjese hiqen pajantat cdo nje meter dhe pasi pastrohet nga mbeturinat do të fillojë rindërtimi i murit. Lidhja ndërmjet dy pjesëve të murit do të realizohet edhe me vendosje e brezave të drurit në pjesën e re dhe lidhja me kushakë (breza tërthorë) me brezin e vjetërnese ka. Rindërtimi i murit do të eliminojë dhe çarjet. Për kompaktësimin e murit mbas rindërtimit, do të jetë e nevojshme injektimi gjatë gjithë sipërfaqes së tij.



13.5 Konsolidim i kreut te murit me 2cm llac gëlqere

Konsolidimi do të realizohet duke pastruar kreun e murit nga llaçi i degraduar, larje dhe injektim (me rënie të lirë). Kreu i murit do të pastrohet dhe nivelohet me llaç gëlqere me trashësi rreth 2 cm. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet të bëhet për përgatitjen e sipërfaqes së dëmtuar të murit, pastrimin, larjen me ujë, konsolidimin e murit të dëmtuar me teknikën e ndërthurjes. Në çmim përfshihet blerja e materialeve, transporti i tyre në objekte dhe çdo punë që lidhet me përfundimin e saj. Në çmim përfshihet edhe transporti i mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia. Ky çmim është për njësi ml.

13.6 Konsolidimi i kreut te murit me 1-2 rreshta gure me llac gelqere 1:3

Ky çmim përfshin konsolidimin e kreut te murit me 1 apo 2 rreshta rrasa guresh per te plotesuar kornizen e sipërme te muratures ne vendet ku ajo mungon, duke përfshire ketu dhe fugatimin e tyre. Per plotesimin e kornizes do te perdoren rrasat e gureve ekzistuese ne gjendje te mire si dhe te tjerat do te plotesohen te njejta me ato eksistueset per nga permasat dhe dimensionet.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³

13.7 Konsolidim strukturor i muraturave prej guri (me dy parete dhe mbushje ne mes) i afreskuar me tekniken e injektimit te mishes me rezistence te larte mekanike dhe perberje te ulet te kriperave te tretshme ne uje.


Ky proces duhet te kryhet me shume kujdes dhe ne menyre graduale e te kontrolluar ne anet e murit me picture ne menyre qe sapo te vihen re njolla te nderpritet menjehere deri sa te realizohet renia e llacit te hedhur dhe ngrirja e tij pasta te vazhdohet me kujdes hedhje ne sasi te vogla te llacit me renie te lire nga lart.

Përbërja e llaçit pa kimikate qe demtojne pikturen. :

Rërë lumi e larë	2 pjesë
Rërë vullkanike me granulacion 0,5-1 cm	2 pjesë
Pluhur tulle e çmërçi dhe copa tulle deri në 2 cm	2 pjesë
Gëlqere e vjetër	3 pjesë

Ky proces pune përfshin konsolidim e carjeve ne ikonostasin prej guri te kishes i cili paraqet carje te thella. Pasi te jete bere pajantimi i muratures dhe mbrojtja e piktures murale do te filloje procesi i qepjes me injektim i muratures ne pjesen e pasme te saj ku nuk ka piktore murale.

13.8 Fugatim muri (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim)



Fugatime do të kryhen në ato raste kur çarjet (fesurat) janë deri të një madhësie mesatare dhe kur vërehet se llaçi ekzistues është i degraduar. Fugatime sipërfaqësore do të aplikohen në ato raste kur çarjet janë të karakterit kapilar me qëllimin e vulosjes së tyre.

Fugatimi do të bëhet edhe për eliminimin e fugave të papërshtatshme, fuga të bëra me llaçra të fortë me përbërje cimento. Këto llaçra nuk përputhen me aparatën e muraturës dhe mund të krijojnë me kalimin e kohës stres mekanik të dukshëm, duke përkeqësuar gjendjen e muraturës.

Fugatimet konsistojnë në pastrimin e llaçit ekzistues të dëmtuar në fasadat e muraturës së jashtme pa suva. Fugatimi do të fillojë me pastrimin mekanik (gërryerjen) të fugave nga llaçi degraduar .

Pas pastrimit mekanik të fugës dhe larjes me ujë të bollshëm do të kryhet mbyllja e fugave. Masa e llaçit të përgatitur, duhet të jetë homogjen dhe uniform. Fugatimi do të kryhet me llaç gëlqere të majmë, me konsistencë të ulët.

Mbasi fillon prezën llaçi, atëhere ai laget dhe fërkohet me furçë teli për të eliminuar plasaritjet eventuale të tij.

Është e rëndësishme të bëhen analiza të miratuara, për të mësuar përbërjen kimiko-fizike të llaçit ekzistues në mënyrë që të përcaktosh qartësisht natyrën, prejardhjen dhe granulometrinë e materialit të përdorur. Përbërja e llaçit duhet të jetë me material analog të atij ekzistues. Përbërja e llaçit të fugave do të pranohet nga mbikqyrësi i punimeve pas provave dhe marrjes së kampionëve në vend dhe nga rezolucioni kromatik që duhet të arrihet në ngjashmëri me llaçin ekzistues.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin dhe heqjen e kujdesshme të shtresës së llaçit në fugat e xokolit me furçë teli të ashpër dhe largimin e mbeturinave nga objekti, transporti i materialeve dhe gjithçka duhet për përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për Lekë/ m².

13.9 Pajantim i muratures se demtuar me elemente derrase

Ky ze punimi përfshin pajantimin e muratures ne faqen perendimore dhe jugore te kishes perpara fillimit te punimeve per perforcimin e themelit si dhe qepjen e carjeve me tekniken shqep-qep te muratures ne ato pjese ku carjet jane te thella. Persa i perket pjeses se brendshme te muratures ne ikonostasin prej guri ku kemi dhe piktura murale do te behet mbrojtja e piktures me sfungjer dhe polisterol perpra fillimit te punimeve per konsolidimin e tij.

Ky çmim është për Lekë/ m².

14.0 Puntelim per ndertim qemeri me elemente derrase

Ky ze përfshin ndertimin e nje kallepi per fillimin e procesit te restaurimit te qemereve prej guri te demtuar.

Ky çmim është për njësi Lekë/m².



14.1 Restaurim kornize dere t=10 cm dhe dritare me pllaka guri

Ky process pune perfshin restaurimin e kornizes prej guri te dyerve ne pjesen e narteksit te cilat jane te demtuara dhe ka mungese te materialit guror te tyre.

14.2 Restaurim i çarjeve në mur guri me teknikën e injektimit (Pastrim i çarjes, larje me ujë, injektim llaç gëlqere 1:3)

Fugatimet sipërfaqësore kryhen në ato raste, kur çarjet janë të një madhësie mesatare dhe llaçi ekzistues është i degraduar.

Përbërja e llaçit do të përcaktohet në bazë të karakteristikave të llaçit ekzistues.

Në çmim përfshihet i gjithë procesi i pastrimit të llaçit ekzistues të dëmtuar në masën deri 3 cm dhe vendosja e llaçit të ri i cili ngjishet mirë. Mbasi fillon prezën llaçi, atëherë ai laget dhe fërkohet me furçë teli për të eliminuar plasaritjet eventuale të tij. Do të realizohen disa mostra fugash për të gjykuar për ngjyrën dhe përbërjen e llaçit dhe do të merret vendim nga supervizori i punimeve.

Në çmim përfshihet çdo punë që lidhet me përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për Lekë/ m² .

14.3 Restaurimi i çatisë me strukturë druri

Fillimisht do të bëhet çmontimi i kujdesshëm i rrasave të gurit duke shpëtuar ato që janë të padëmtuara e të forta konstruktivisht duke i seleksionuar me kujdes për tu ripërdorur më vonë. Heqjen me kujdes të rrasave të gurit dhe seleksionimi i rrasave të pa dëmtuara, të cilat do të depozitohen dhe zbriten me kujdes në tokë nëpërmjet ulluqeve të krijuar, dhe rradhiten , për t'u ripërdorur, duke i sistemuar sipas grupimeve në terren. Rrasat e gurit në gjendje të mirë dhe dimension të përshtatshëm, që do të ripërdoren, duhet të lahen dhe pastrohen me furçë të ashpër në mënyrë që nga sipërfaqja e tyre të largohen të gjitha llojet e myshqeve dhe papastërtitë e tjera, duke krijuar një sipërfaqe perfekte të tyre.

Do të bëhet çmontimi me kujdes i petavrave të çatisë duke shpëtuar ato elemente drusor që janë të padëmtuara e të forta konstruktivisht duke i seleksionuar me kujdes për tu ripërdorur më vonë. Më tej kontrollohet cilesia dhe gjendja faktike e gjithë elementëve drusorë duke ruajtur elementët e mirë të strukturës mbajtëse bazë dhe duke zëvendësuar ndonjë element të degraduar dhe jashtë kushteve teknike për zbatim.

Plotësimi i elementeve te hequr, duke respektuar përmasat e konstruksionit të hequr dhe skemën tradicionale të çatisë. Gjendja e elementëve të konstruksionit do të kontrollohet nga mbikqyrësi i cili do të vendosë se cilët elementë do të ruhen dhe cilët jo. Trarët të cilët janë janë degraduar ose janë të deformuar dhe ndikojnë në konstruksionin e çatisë, do të hiqen dhe do të ruhen për zëvendësimin e tyre me material të shëndoshë sipas përmasave, materialit dhe teknikës origjinale të elementit, ndersa materialet e padëmtuara të cilat do të qëndrojnë në çati, do t'u nënshtrohen proceseve të konservimit duke iu nënshtuar një trajtimi dizenfektues ndaj agjentëve atmosferikë dhe krimbave e kërpudhave me antimol e insekticid



dhe vaj lini. Trarët tërthore të çatisë do të mbështeten mbi breza druri gjatësore të vendosur mbi kreun e murit të gurit pas konsolidimit të tij.

Rindërtimi i dyshemesë së drurit do të bëhet me petavrat egzistuese në gjendje të mirë . Elementët e dyshemesë të dëmtuara të zëvendesohen me elementë të rinj me përmasat dhe llojin e materialit egzistueses. Dyshemeja me petavra pas përfundimit do të trajtohet me solucion antimol, anti lagështirë, insekticid dhe në fund do të lyhet me 2 duar vaj lini.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m² çati në plan .

14.4 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama

Membrana hidroizoluese e çatisë do të përzgjidhet në konsultë me mbikqyrësin e punimeve në mënyrë që të përshtatet cilesia me kushtet specifike që kërkon çatija e nje objekti të tillë. Kontraktori do të sjellë kampionë të ndryshëm të çertifikuar, nëse ato nuk ofrojnë karakteristikat e kërkuara nga mbikqyrësi i punimeve do të refuzohen. Është mirë që këto membrana të sigurojnë ajrosje të çatisë.

Realizimi i shtresës hidro izoluese do të bëhet mbi sipërfaqe të pastruar e thare mirë të shtresës së petavrave duke përfshirë pjesën vertikale, do të jetë e përbërë nga një membranë guaine 4 mm, të vendosur në vepër mbi sipërfaqe të rrafshët , përfshirë mbivendosjen e lidhjeve minimumi 12 cm dhe do të ngrihet në drejtimin vertikal në muret anësore me min. 10 cm. Kjo punë përfshin mbërthimet heqjet, spostimet si dhe cdo detyrim tjetër të nevojshëm për t'i dhënë fund procesit.

Kujdes i veçantë duhet të merret në përgatitjen e sipërfaqeve të papërshkueshme nga uji; ndonjë pikë e mundëshme e hapur duhet të mbyllet me silikon dhe të stukohet .

Sugjerohet që shtresa hidroizoluese të sigurojë hidroizolim absolut kundër ujit dhe lagështisë. Gjithashtu duhet të ketë një depërtueshmëri të kënaqshme të avullit që lejon kalimin e avullit por jo të ujit. Duhet të ketë peshë të lehtë dhe rezistencë të lartë mekanike. Rezistencë ndaj ndryshimeve të temperaturës. Rezistencë të lartë ndaj zjarrit.

Element tjetër i izolimit në çati do të jetë dhe mbulimi i bashkimeve të mureve vertikal (pikat ku bashkohen çatitë e nivelit të ulët me muret vertikal) me impluve bakri e cila do të realizohet duke ju veshur muraturës vertikale dhe duke u inkastruar në llaçin izolues horosan, në mënyrë që të eliminojë përfundimisht hyrjen e lagështires edhe në këto pika të rrezikshme të bashkimit të dy planeve, vertikale me horizontale. Mbulimi i çatisë do të realizohet rigorozisht në kuotat e vjetra dhe në pjerrësitë e harkimet e mëparshme duke përdorur rrasat e gurit egzistuese të ruajtura mirë dhe seleksionuara si dhe nëse do të jetë e nevojshme, do të plotësohet me rrasa gurit të ngjashme me të vjetrat.

Kjo jepet për njësi Lekë/m².



14.5 Restaurim strehe catie me rrasa guri pa dekor

Ky zë punimi përfshin restaurimin e kornizës prej guri pa dekor te portes ne faqen veriore te kishes.

Kjo jepet për njësi Lekë/m².

14.6 Mbulim çatie me tjegulla vendi

Ky ze punimi përfshin ndertimin e catise se re me tjegulla vendi sipas menyres se dizenuar ne fletet e vizimit. Materiali qe do te perdoret eshte dru pishe i stazhionuar me solucion antimol dhe vaj lini dhe insekticid. Prezenca e lageshtires nuk duhet te jete me shume se 10%.

Keto punime do te kryhen pasi te jete konsoliduar kreu i siperm i muratures si dhe vendosja e brezit te vazhduar prej druri per montimin e catise se re.

Lenda e rrumbullaket (traret terthore) qe do te perdoret ne kostruksinin e catise, do te jete e inkastruar ne mure, nen kuoten e fundit te catise, duke hapur fole ne vendosjen e cdo lende. Edhe lenda e rrumbullaket duhet te jete e pastruar nga lekurat dhe mundesisht te jete siperfaqe e paster dhe pa nyje, ne menyre qe te mos pesojne keputje. Edhe lenda e rrumbullaket duhet te jete gjithashtu e stazhionuar, e impenjuar ne vaj lini dhe insekticid dhe me prezence te lageshtires deri ne 10%.

E gjithe siperfaqia e catise, do te jete e shtruar me dysheme derrase (petavra) $t = 2.5 * 15 \div 20$ cm (dru pishe i stazhionuar). Petavrat do te jene pishe te stazhionuara dhe te impenjuara me solucion antimol, anti lagështirë, insekticid dhe me vaj lini. Petavrat do të vendosen 1-2 cm larg nga njera-tjetra për të siguruar ajrosjen e çatisë duke u gozhduar me gozhde 4 cm .

Mbi derasa ne forme te rregullt shtrohen rreshtat e tjegullave, te cilat sherbejne si mbulese perfundimtare per catine, te cilat ne kulmet e tyre kapen me llac-gelqere , per te mos lejuar shkarjen e tyre.

Lënda e drurit e cila do të përdoret do të jetë dru pishe e stazhionuar mirë dhe e cilësisë së lartë, me karakteristika:

- ❖ Lagështi jo më tepër së 10 %,
- ❖ Peshë volumore 410 – 540 Kg/m³,
- ❖ Kufiri i rezistencës në tërheqje 130 MPa,

Të gjitha materialet që do të përdoren do të jenë të pajisura me çertifikatë cilësie përvec rrasave nëse janë të ripërdorura.

Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme, transporti i tyre, ngarkim shkarkimi, skelera dhe çdo punë që lidhet me të.

Kjo jepet për njësi Lekë/m² çati të përfunduar në plan.



14.7 Konsolidim / Restaurim dhe Plotesim shtrese pllaka guri)

Proçesi i restaurimit të shtresave me rrasa guri, do të aplikohet në rastet kur rrasat e dyshemesë paraqesin disnivele, apo çarje të formatit të tyre. Në raste të tilla, do të ndërhyhet me heqjen e pllakave, nivelimin dhe ngjeshjen me tokmak të sipërfaqes së truallit ku qendrojnë dhe më tej, rivendosjen e tyre direkt në truall pa shtesë lidhëse, në përputhje me sipërfaqen. Për pllakat e çara, të shihet mundësia e riparimit me anë të pastrimit dhe përputhjes së buzëve bashkuese si dhe ngjitjes, kur është e mundur. Zëvendësimi dhe plotesimi i pjeseve ku ka mungese të materialit guror të bëhet me material të njëjtë me atë ekzistues (vetëm në rast kur mungon totalisht).

Në çmim përfshihet, gjithcka duhet për përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për lekë / m².

14.8 Shtrese me pllaka guri (Narteksi)

Pasi të jete bere germimi i dherave të grumbulluar në ambientin e narteksit dhe të gjendet kuota e dyshemesë ekzistuese do të bëhet shtrimi i kësaj pjese me pllaka guri në të njëjten mënyrë si dyshemeja ekzistuese pasi të kemi bere zbulimin e saj.

Ky çmim është për lekë / m².

14.9 Restaurim shkalle guri

Ky ze punimi përfshin restaurimin e shkallës prej guri në hyrje të altarit e cila ka mungese të materialit guror. Do të bëhet pastrimi, nivelimi, konsolidimi i pllakave që levizin si dhe plotesimi me pllaka të ngjajshme me ato ekzistueset në vendet ku mungojnë.

15.2 Nenshtrese zhavorri

Ky çmim përfshin sistemimin e territorit perimetral të kishës ku do të bëhet shtrimi me pllaka guri, në një shtresë zhavorri. Sipas fleteve të vizatimit.

Ky çmim është për lekë / m².

15.3 Bordure guri 25*12

Ky ze punimi përfshin vendosjen e një bordure guri për krijimin e një trotuari në të dy krahet e kishës sipas fleteve të vizatimit.

Ky çmim është për lekë / ml



15.4 Shtrese me pllaka guri pa llac

Krijimi i nje trotuari ne te dy krahet e kishes me pllaka guri mbi nje shrese zhavorri 10 cm pac lidhes, sipas fleteve te vizatimit. Trotuari do te jete 10 cm me poshte sesa kuota e dyshemese se brendshme te kishes per te mos lejuar depertimin e lageshtise ne brendesi te saj dhe do te kete nje pendence per nga jashte me 2%

Ky çmim është për lekë / m².

15.5 Suvatim fasade mur guri me krah brenda, llaç gëlqere 1:2

Sipërfaqja e suvatuar do të kontrollohet e gjitha duke evidentuar suvatimin e shkëputur, i cili do të prishet deri në gur. Do të evidentohen çarje të mundshme në fasadë. Fasadat do të lahen me ujë të bollshëm duke pastruar sipërfaqen nga pluhurat. Fillimisht do të kryhen stukimet, qepjet e çarjeve të mundshme dhe sistemimi i sipërfaqeve ku është i nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç gëlqere 1:3 me më shumë shtresa edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin. Përpara se të vendoset shtresa e suvasë duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Llaçi i suvasë nuk duhet të aplikohet në $t_m \leq 5^\circ C$.


Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2cm llaçi gëlqere 1:3 i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15cm çdo 1 deri në 1,5m), dhe e lëmuar me mistri e përdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Llaç gëlqere ajrore duhet të ketë këto karakteristika :

- ❖ Kufiri i rezistencës në shtypje 25 kg/cm²,
- ❖ Peshë volumore 1800 kg/m³,
- ❖ Konsistenca, ≤ 8
- ❖ Papastërtia e rërës 12 %,
- ❖ Moduli, 1.8
- ❖ Raporti G:R 1:3

Rëra për suva duhet të jetë e përbërë nga kokriza të dimensioneve të tilla për të kaluar në sitë me përmasa 1mm.

Në këtë zë punimesh përfshihen çmimet që duhen për të realizuar sipas kushteve teknike riparimet e suvatimeve të mureve të jashtëm guri, përgatitja e sipërfaqes së murit pastrimi nga pluhuri, lagia, vendosja e shtresës së suvasë deri në tharje, dora e dytë, dhe finoja, skeleritë e nevojshme. Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme me cilësi, transporti i tyre, skeleri, përpunimi dhe vendosja në objekt, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të.



Ky çmim është për Lekë/ m².

15.6 Lyerje - sherbetosje me gëlqere

Proçesi i lyerjes së sipërfaqeve të mureve kalon nëpër tre faza si më poshtë:

- ❖ Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet

Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e gëlqeres së mëparshme nga sipërfaqja e lyer, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit dhe bërja gati për paralyerje. Përpara fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

- ❖ Paralyerja e sipërfaqes së pastruar

Në fillim të proçesit të lyerjes, bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqeren të holluar (Astari). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg gëlqere me një litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m² sipërfaqe.

- ❖ Lyerja me gëlqere e sipërfaqes

Lyerja bëhet me dy duar bojë gëlqere e stazhonuar mirë.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve të sipërpërmendura, transportine materialit, skeleri.

Ky çmim është për Lekë/ m².

15.7 F.V. Dyer dhe dritare druri

Dyert dhe dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitektonike dhe funksionale e ndërtesës. Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (dimensionet) e tyre duhet të jetë sipas modelit origjinal. Dyert dhe dritaret do të prodhohen prej druri pishe, të stazhionuar, dhe imprenjuar dhe do të lyhen me vaj lini dy duar.

Pjesët kryesore të dritareve janë: Kasa e dritares që fiksohet në mur me elemente prej hekuri përpara suvatimit. Korniza e dritares do të vidhohet me kasën e saj mbas suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të formës dhe përmasave të dritareve ekzistuese, korniza do të pajiset në kasë me mentesha dhe bllokues të tipeve të ndryshme të instaluara në të. Kanatë me xhama të pahapshme, të pajisur me doreza të fiksuara dhe me ngjitës transparent silikoni, si dhe me kanata fikse.

Kujdes duhet treguar me përputhjen e kasave me hapësirat përkatëse si dhe të jenë të plotësuara me aksesori.

Vendosja e dyerve në vepër duhet të bëhet sipas kushteve teknike për montimin e tyre të dhëna në standartet shtetërore. Mënyra e vendosjes së tyre është në varësi të llojit të derës



dhe materialit që përdoret për prodhimin e tyre. Për modelin e dyerve do t'i referohet modelit original dhe konsultave në vend me supervizorin.

Kampione të artikujve të propozuar, do ti paraqiten paraprakisht mbikqyrësit të punimeve për aprovim paraprak.

Druri i pishës do të ketë këto karakteristika.

- Lagështi jo më tepër së 7-8 %,
- Peshë volumore 410-540kg/m³,
- Kufiri i rezistencës në tërheqje 130 MPa,

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve të sipërpërmendura, materialin drusor të përpunuar nga specialistët si dhe aksesorët, furnizimin dhe vendosjen në vepër, transportin dhe ngarkim shkarkimine tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

Ky çmim është për lekë/ m².

15.8 Lyerje me antimol e insekticid

Mbrojtja e drurit nga mikroorganizmat dhe insektet të natyrave të ndryshme, kërkon ndërhyrje të niveleve të ndryshme: eliminim të substancave të alterueshme që përmban druri, apo mbrojtja e tij me insekticid që përvec se pengojnë rritjen e mikroorganizmave, kërpudhave dhe insekteve mund edhe të parandalojë përthithjen e padëshiruar të ujit nga ambienti nëse ai është vajor.

Trajtimi me insekticid i drurit dhe substancat e përshtatshme për një disinfektim korrekt duhet të ndjekin këto faza:

- biocidi duhet të godasë direkt larvat dhe vezët në mënyrë që ti eliminojë totalisht.

- të gjitha zonat me sipërfaqe të ekspozuara duhet të trajtohen me insekticid dhe biocid të lëngshëm me penetrim të lartë për të krijuar një zonë me helm përmes të cilës do të kalojnë insektet ksilofag për të dalë në sipërfaqe.



- trajtimi sipërfaqësor duhet të përmbajë një shtresë insekticidi në sipërfaqe dhe në të gjitha carjet e drurit;

Ndërhyrja e dezinfektimit duhet të jetë e tillë që të eliminojë agjentët biologjikë negativë ekzistues dhe të parandalojë degradime të mundshme të materialit drusor në të ardhmen.

Solucioni do të aplikohet me spruco apo me penel, duke përsëritur trajtimin 2/3 herë rradhazi, për të lejuar insektin të penetrojë në dru sa më thellë të jetë e mundur. **Duhet evituar përdorimi i produkteve në tretësirë ujore pasi kapaciteti i penetrimit varet nga lagështia e drurit.**



Përpara përdorimit të insekticidëve (kanë avantazhin që nuk kanë erë), është e nevojshme lagia e drurit me ujë para çdo aplikimi. *Me një 1kg insekticid mund të trajtohet një sipërfaqe prej 3m².*

Insekticidët e shkrirë në tretës organik preferohen të kenë kapacitet të madh penetrimi në drurin e thatë përmes një procesi të shpërndarjes dhe përthithjes në thellësi. Insekticidet duhet të jenë eksperimentuar edhe më parë dhe të jenë të pranuar nga praktika restauruese duke plotësuar kriteret që të jenë jotoksikë, rezistent ndaj dritës dhe rrezeve UV dhe të mos prodhojnë alterime kromatike.

Produktet e përdorshëm për desinfektim mund të jenë:

Desinfektimi i trarëve të çatisë – do të përdoren tretës në ujë vetëm në kushte të vecanta dhe do jenë me bazë të përzierjes së fluorit të natriumit dinitrofenol dhe bikromat, poliborat natriumi.

Kërpudhat – trajtimi antimyk (kundër kërpudhave) do parashikojë produkte efikas edhe kundër insekteve, do të trajtohet në përgjithësi produkte me bazë fluori të përbërë nga kromi dhe arseniku, pentaklorofenol etj. Është e rrallë që kërpudha të ketë kapacitet të zhvillohet në lagështi më të vogël se 22%, dmth vlera të lagështisë 12/14% përjashtojnë cdo rrezik, në cdo rast druri që do të përdoret duhet të jetë i stazhionuar.

Pas kryerjes së ndërhyrjes që garanton eliminimin dhe/ose parandalimin nga një nivel anomal lagështire, elementët drusor të infektuar dhe që nuk plotësojnë standartet teknike të



përdorimit mund të hiqen apo digjen. Mund të rezultojë i nevojshëm të kryhet një ndërhyrje radikale nëpërmjet injeksioneve me biocid.

Shkalla e degradimit të elementëve drusorë do të gjykohet pas hapjes së cative dhe mbikqyrësi i punimeve do të vendosë mënyrën dhe llojin e aplikimit për elementët drusorë.

Në përgjithësi substancat antiseptike preferohen me fuqi të madhe të biocidit dhe të mos jenë të dukshëm pas aplikimit.

Përbërësit me fluor janë të përshtatshëm për eliminimin e kërpudhave.

Mund të jetë e nevojshme përdorimi i disa përzierësive për të arritur një përmirësim të biocidit.

Do të preferohen përzierje me bazë fluori apo dinitrofenol dhe florur natriumi (raport 11:89) me shtesë ose jo të arsenikut; përzierje të florurit me kripëra të arsenikut të natriumit;

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve për lyerjen e elementëve të drurit me insekticid e biocidë sipas metodologjisë dhe materialeve të përshkruar me të paktën dy duar, blerjen e materialit, transportin, skeleri dhe çdo punë që lidhet me të.

Ky çmim është për njësi Lekë/m².

Përsa i përket lëndës së drurit me të cilën do të bëhet çatia dhe dyshemeja e saj, e cila duhet të jetë e stazhionuar më parë, me një përqindje lagështire jo më të madhe se 10%, duhet të lihen në govata të mbushura me material të përzier me vaj lini dhe insekticid për tre ditë (të imprenjohen), dhe pastaj të nxirren dhe të thahen për një javë, në një ambient të thatë, derisa tharja të jetë e mirë, e pastaj të përdoren. Kjo govatë, duhet të ngrihet në kantjer dhe të kontrollohet rreptësisht nga mbikqyrësi i punimeve, pasi kryerja e këtij procesi është sa delikat dhe i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e jetëgjatësinë e çatisë.

15.9 Lyerje me 2 duar vaj lini i elementeve drusorë të catise

Lyerja e elementëve drusorë të fasadave do të bëhet për të mbrojtur këto elemente si dhe uniformizuar ngjyrën e të gjithë këtyre elementëve.

- ❖ Për elementët origjinalë të lyer me vaj lini do të pastrohet paraprakisht sipërfaqja nga pluhurat dhe depozitimet me kompresë me ujë të ngrohtë si dhe me alkool të holluar në ujë dhe më pas do të vazhdohet lyerja me vaj lini pa ngjyrë në mënyrë që të evidentohet ngjyra origjinale e elementëve.
- ❖ Për elementët drusorë të lyer me bojë vaji apo llak, do të bëhet pastrimi e zmerilimi i sipërfaqes sic e kemi shpjeguar më sipër në mënyrë që të arrihet përthithja e vajt të linit me ngjyrë të errët sipas ngjyrës së evidentuar të elementëve origjinalë.

Vaji i linit duhet të jetë i shumë i pastër, me erë të fortë dhe shije të hidhur, i papërzier me vajëra mineral, vaj peshku apo të ndonjë lloji tjetër. Nuk duhet të lërë asnjë depozitim mbetje nëse e hedhim në lastër qelqi apo metal. Duhet të lihet të thahet komplet në



intervalin e 24 orëve. Nuk duhet të ketë më tepër se 7% aciditet, 1% papastërti dhe në temperaturën 15°C një densitet 0.91-0.93. Lyerja duhet të bëhet me vaj lini.

Përpara fillimit të këtij procesi mbikqyrësi i punimeve të restaurimit, duhet të bëjë një kontroll të kujdesshëm të përcaktojë dhe lërë qartë detyrat kontraktorit për trajtimin e secilit element sipas përcaktimeve të mësipërme.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve për lyerjen e elementëve të drurit me vaj lini të paktën dy duar, blerjen e materialit, transportin, skeleri dhe çdo punë që lidhet me të.

Ky çmim është për njësi Lekë/m².



16.1 Bojë vaji sipërfaqe metalike

Ky zë përfshin lyerjen e elementëve metalikë të inkastruar në kasat e dritareve si dhe te korimanos ne fasaden veriore, pas verifikimit në vend nëse këto mund të ripërdoren, të cilët fillimisht do të pastrohen me letër smeril, do të lyhen me antiruxhë dhe në përfundim me dy duar bojësë vaji.

Ky çmim është për njësi Lekë/m².

PERGATITEN RELACIONIN

Ark. Ronela Çuku

Ark. Vilma Hashorva

Ing. Bledian Rakipi



Digitally signed by
Ronela çuku
Date: 2025.03.21
13:32:18 +02'00'
Vulosur elektronikisht nga
Trashëgimisë Kulturore
Date: 2025/04/17 10:48:51 +02'00'
d16d1a952fde42beac7b62e05e454ffa2025041710
484371040

Digitally signed by
Bledian Rakipi
Date: 2025.03.21
13:46:10 +02'00'

Digitally signed by
Vilma Hashorva
Date: 2025.03.21
14:00:48 +02'00'

Digitally signed by Joli
Mitrojorgji
Date: 2025.04.10
16:57:27 +02'00'

Digitally signed by
Joli Mitrojorgji
Date: 2025.04.17
10:47:48 +02'00'

